

APLIKIM NË PROGRAMIN ”PUNO DHE STUDIO” PËR VITIN AKADEMIK 2015/2016

Si pjesë e pakos së ndihmave financiare, UEJL edhe gjatë vitit akademik 2015/16 do t’ju mundësojë studentëve që të anagazhohen në programin ”Puno dhe studio” sipas kushteve të mëposhtme:

- ✓ Paga e studentit nuk mund të tejkalojë koston e mësimit
- ✓ Angazhimi maksimal është deri në 15 orë punë në javë dhe studenti mund të angazhohet më së shumti deri në shlyerjen e shkollimit të një viti akademik gjatë kohëzgjatjes së studimeve.
- ✓ Të drejtë aplikimi në programin ”Puno dhe studio” kanë të gjithë studentët që gjatë vitit akademik 2015/16 ndjekin studimet e rregullta në UEJL, por përparësi do të kenë studentët që do të dëshmojnë se kanë nevojë për përkrahje financiare si dhe ata që do të dëshmojnë shkathtësi për vendin e punës.
- ✓ Studentëve që janë të akorduar me bursë apo ndihmë financiare nga cilido fond në vitin paraprak dhe vijues akademik nuk u mundësohet të angazhohen në programin ”Puno dhe studio”.

Departamentet ku do të mundën të angazhohen studentët janë të potencuara më poshtë :

- | | |
|------------------------------------|-----------------------------|
| 1. Bibliotekë Tetovë/ Shkup | 6. Departamenti IT-së |
| 2. Qendra e Karrierës | * <i>IT - Support</i> |
| 3. Shërbimi Studentor Tetovë/Shkup | * <i>CST Laboratories</i> |
| 4. Instituti për ambient jetesor | 7. Mirëmbajtje - Gjellbërim |
| 5. Qendra e gjuhëve | 8. SEEUTech Park |

- Angazhimi në këtë program do të bëhet sipas kriterëve:

1. Nevoja për ndihmë financiare
2. Aftësitë për vendin e punës

- *Kriteri i parë (Nevoja për ndihmë financiare) duhet të verifikohet në bazë të dokumentacionit të prezantuar.*
- *Kriteri i dytë (Aftësia për vendin e punës) do të verifikohet në intervistat që në veçanti do të mbahen me një numër të caktuar të aplikuesve pas përzgjedhjes në bazë të kriterit të parë*

- *Lista e termineve për intervistë, për ç’do vend pune do të shpallet pas 20 shtatorit tek Zyra për Ndiham Financiare, ndërtesa (802).*

- Aplikacionet mund të merren duke klikuar [KËTU](#), në kampusin universitar në Shkup dhe te Zyra për Ndiham Financiare-Tetovë, ndërtesa (802.10) ku edhe duhet të dorëzohen brenda afatit të përcaktuar

Afati për aplikim – prej 12. 05. 2015 deri me 25. 05. 2015

- *Për studentët e rrinj (brucoshët) afati i aplikimit është prej 01. 09. 2015 deri me 15. 09. 2015*

Angazhimi i studentëve në punë do të bëhet prej 05. 10. 2015